

VENDIM
Nr. 1, datë 30.4.2025

PËR PËRCAKTIMIN E SHTETEVE QË SIGUROJNË NJË NIVEL TË MJAFTUESHËM TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të pikave 2 dhe 3, të nenit 40, germës “gj”, pikës 1, të nenit 82, pikës 1, të nenit 85, dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

VENDOSI:

1. Shtetet që sigurojnë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, mbështeten në kriteret si më poshtë:

a) shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, që zbatojnë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), e cila përbën një akt të përbashkët, drejtpërdrejtë të zbatueshëm, që përmban parimet thelbësore dhe rregullat e përpunimit të të dhënave personale;

b) shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Evropiane, që në bazë të Marrëveshjes së EEA¹-së, zbatojnë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR);

c) palët e Konventës 108 të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, si dhe protokollit të saj shtesë të vitit 1981, të cilat kanë miratuar një ligj për mbrojtjen e të dhënave dhe kanë krijuar një autoritet mbikëqyrës që ushtron funksionin e tij me pavarësi të plotë, duke siguruar mekanizma ligjorë të përshtatshëm, përfshirë trajtimin e ankesave, hetimin dhe garantimin e transparencës në përpunimin e të dhënave personale;

ç) shtetet, ku transferimi i të dhënave personale, mund të kryhet sipas një vendimi përshtatshmërie të Komisionit të Bashkimit Evropian;

d) me vendim të Komisionerit për shtetet ose organizatat ndërkombëtare që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 40, pika 3, të ligjit.

2. Shtetet që konsiderohen se garantojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale sipas kriterëve më sipër, janë të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 8, datë 31.10.2016, “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi**

ANEKS NR. 1
VENDET TË CILAT KANË NIVEL TË MJAFTUESHËM PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

¹ *European Economic Area (EEA) – Zona Ekonomike Evropiane.*

- Andorra - Argjentinë - Austri - Belgjikë - Bosnjë dhe Hercegovinë - Bullgari - Danimarkë - Estoni - Finlandë - Francë - Greqi - Guernsey - Gjeorgji - Gjermani - Holandë - Hungari - Irlandë - Islandë - Ishulli i Manit - Ishujt Faroe - Itali - Izrael - Japoni - Jersey - Kanada² - Koreja Jugore - Kosovë	- Kroaci - Letoni - Lihtenshtajn - Lituani - Luksemburg - Mal i Zi - Maltë - Maqedoni e Veriut - Mbretëri e Bashkuar - Moldavi - Monako - Norvegji - Poloni - Portugali - Qipro - Republikë Çeke - Rumani - San Marino - Serbi - Sllovaki - Slloveni - Spanjë - Suedi - Shtetet e Bashkuara të Amerikës³ - Uruguaj - Zelandë e Re - Zvicër
--	---

² Niveli i mjaftueshëm zbatohet vetëm për shoqëritë tregtare sipas vendimit të Komisionit Evropian 2002/2/EC, datë 20 dhjetor 2001.

³ Niveli i mjaftueshëm zbatohet vetëm për shoqëritë tregtare që aderojnë në Kuadrin për Mbrojtjen e të Dhënave BE–SHBA sipas vendimit të Komisionit Evropian 2023/1795, datë 10 korrik 2023.